

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Interinvest Albanian Group” sh.p.k**

Sot, më datë 12 Dhjetor. 2022, në Tiranë, Shqipëri, subjektet dhe personat e mëposhtëm:

1. **Z. Hergys Rreli**, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë më 24.09.1981, mbajtës letërnjoftimit me nr. Personal I10924042Q.
2. **Z. Bujar Bendo**, lindur më 02.07.1966 në Lushnje dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. personal G60702148I.
3. **Z. Nelsi Gega**, shtetas Shqiptar, lindur në Lushnje më 16.01.1987 dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. Personal I70116059V.

Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 ”Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, vendosën të krijojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar **Interinvest Albanian Group shpk**, duke nënshkruar këtë Akt Themelimi dhe Statut. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është i njëjti dokument me Aktin e Themelimit, si vijon:

**KAPITULLI I**

**EMRI, FORMA E SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA**

**Neni 1**

**Themelimi**

- 1.1 Emri i shoqërisë është **Interinvest Albanian Group shpk**.
- 1.2 Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.3 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 1.4 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin e saj.


**Neni 2**

**Selia**

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: *Njesia Bashkiake nr.5 ,rruga Skender*

*Luarasi ,sheshi Gjenerali Jozef San Martin, ZK. 8270,nr. pasurie 8/422-N20, vl. 96,*

*Fq.105. Tiranë, Shqipëri..*



- 2.2 Shoqëria mund të themelojë dege, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose në shtete të tjerë, në përputhje me ligjin dhe statutin.

### **Neni 3**

#### **Objekti**

Shoqëria ka objekt veprimtarie:

- 3.1 Investitor dhe investime në fushën e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, kuota, aksione dhe të tjera të ngjashme, sikur vijon :
- 3.1.1 Investitor dhe investime në fushën e ndërtimit. Të tregtojë, ndërmjetësojnë rolin e agjentit real estate për transaksione të pasurive të patundshme të gjitha llojeve brenda dhe jashtë kufijve shtetëror shqiptar. Te jap me qera, ndërmjetësoj për dhënie me qira, huapërdorje dhe çdo lloj forme tjetër administrimi të pasurive të paluajtshme. Konsulenca të përgjithshme dhe çdo veprimtari tjetër që ka të bëjë me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme.
- 3.1.2 Aktivitet të transportit për nevojat e veta dhe të tretëve, pjesëmarrje me kuota dhe aksione në shoqëri dhe ndërmarrje të tjera .
- 3.1.3 Shoqëria gjithashtu do të kryejë dhe realizimin e çfarëdolloj aktiviteti të lejuar nga ligji, për nevoja të veta dhe për të tretë.

### **Neni 4**

#### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë është **10 (dhjetë) vjet**.

## **KAPITULLI II**



### **KAPITALI FILLESTAR THEMELTAR, KONTRIBUTET, KUOTAT-PJESËT E**

#### **KAPITALIT**

### **Neni 5**

#### **Kapitali Themeltar dhe Ortakët**

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është me vlerën 10,000,000(dhjetë milion) leke, i ndarë në 3 (tre) kuota.
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë zotërohet nga ortakët e mëposhtëm:
- Z.Hergys Rreli, zotërues i një kuote të vetme të shoqërisë, për 4,000,000(kater milion) leke, ose 40% (dyzete për qind) të kapitalit themeltar me të drejte vote.
  - Z. Bujar Bendo, shtetas shqiptar, zotërues i një kuote të vetme të shoqërisë, për 4,000,000(kater milion) leke, ose 40% (dyzetë për qind) të kapitalit themeltar me të drejte vote.



- iii. Z.Nelsi Gega, shtetas Shqiptar, zotërues i një kuote të vetme të shoqërisë, për 2,000,000(dy milion) leke, ose 20% (njëzetë për qind) të kapitalit themeltar me të drejte vote.
- 5.3 Kapitali themeltar nënshkruhet dhe shlyhet me kontribute nga ortakët themelues të shoqërisë, me afat maksimal deri në një vit nga themelimi. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin e shoqërisë.

#### **Neni 6**

#### **Transferimi i kuotave, Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit**

1. Çdo Ortak në mënyrë të pakushtëzuar, mund t'ia transferojë pjesët e tij në kapitalin e shoqërisë çdo pale të tretë.
2. Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme me  $\frac{3}{4}$  e votave. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe në natyrë si dhe nga financime të oratekeve, nëpërmjet emërimit nga Asambleja e Përgjithshme të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit/ve.



### **KAPITULLI II**

### **ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË**

#### **Neni 7**

#### **Asambleja e Përgjithshme**

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme është organi me i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.
- 7.2 Asambleja e Përgjithshme ka funksionet e mëposhtme:
- a. Përcakton politikën tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikëqyr zbatimin e këtyre të fundit nga administratorët;
  - b. Emëron dhe shkarkon administratorët;
  - c. Emëron dhe shkarkon ekspertin(et) kontabël dhe/ose likuiduesin(et) e Shoqërisë;
  - d. Miraton shpërblimin e administratoreve, eksperteve kontabël dhe likuiduesve;
  - e. Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga administratorët;
  - f. Merr vendim për ndryshimet e këtij Statuti dhe të Aktit të Themelimit;
  - g. Merr vendim për zmadhimin, zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;



- h. Merr vendime per largimine ortakeve sipas ligjit dhe per anullimin e kuotes ne rast mos derdhjes se kontributit themeltar,mbeshtetur ne statur ;
- i. Merr vendim për shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
- j. Merr vendim për riorganizimin e Shoqërisë ose prishjen e saj;
- k. Merr vendim për çdo çështje tjetër të parashikuar nga ligji.

## Neni 8


### Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- 8.1 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të thirret nga Administratori(rët) apo secili prej Ortakeve sipas legjislacionit në fuqi.
- 8.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme zhvillohet normalisht në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjetër brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.
- 8.3 Asambleja e Përgjithshme shprehet në mënyrë të veçantë për çdo çështje të rendit të ditës, për të cilën duhet të merret një vendim i veçantë.
- 8.4 Ortakët mund të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë. Administratori(ët) e Shoqërisë nuk mund të përfaqësojnë Ortakët në Asamblenë e Përgjithshme.

## Neni 9

### Procesi i vendimmarrjes

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme mblidhet sa herë që është e nevojshme, por në çdo rast të paktën një herë në vit.
- 9.2 Asambleja e Përgjithshme quhet e mbledhur rregullisht kur janë të pranishëm Ortakët që zotërojnë më shumë se 30% të kapitalit të Shoqërisë. Në mungese të kuorumit të kërkuar, mbledhja shtyhet me të njëjtin rend dite.
- 9.3 Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicë të thjeshtë në lidhje me çështje për të cilat ligji nuk kërkon një shumicë të cilësuar, përcaktuar në pikën 9.4 më poshtë.
- 9.4 Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të cilësuar prej 3/4 e votave të ortakëve të pranishëm në lidhje me:
  - i. Ndryshimin e Statutit;
  - ii. Rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - iii. Shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
  - iv. Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.
- 9.5 Asambleja e Përgjithshme për vendimet sipas pikës 9.4 quhet e mbledhur rregullisht kur janë të pranishëm Ortaket që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë. Në





mungesë të kuorumit të kërkuar, mbledhja shtyhet për 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.

## Neni 10

### Administratori

- 10.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) ose disa administrator bashkërisht, të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.
- 10.2 Administratori i parë i Shoqërisë është:
- 10.3 **Z. Nelsi Gega**, atësia Kadri, lindur më 16.01.1987, në Lushnje dhe banues në Tiranë, mbajtës i ID numër personal I70116059V. Mandati i Administratorit është për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, i rinovueshëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin administratorit të ri.
- 10.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori.
- 10.5 Përveçse kur parashikohet ndryshe me vendimin përkatës të Asamblesë së Përgjithshme për emërimin administratorit, administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
- Administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare dhe ekonomike të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme;
  - Përfaqësimin e Shoqërisë në marrëdhënie me çdo palë të tretë;
  - Marrjen e masave për hartimin dhe mbajtjen në mënyrën e duhur të pasqyrave financiare dhe të dokumenteve;
  - Përgatitjen dhe nënshkrimin e pasqyrave financiare vjetore dhe bilanceve të konsoliduar, përgatitjen e raportit të ecurisë dhe dorëzimin e këtyre të fundit bashkë me propozimin përkatës për shpërndarjen e fitimeve Asamblesë së Përgjithshme;
  - Krijimin e sistemit të paralajmërimit në lidhje me rrethanat të cilat kërcënojnë veprimtarinë e Shoqërisë;
  - Dorëzimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të dokumenteve dhe të dhënave të Shoqërisë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe;
  - Raportimin në Asamblesë të Përgjithshme të Ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe në lidhje me përmbushjen e transaksioneve të një rëndësie të veçantë për ecurinë e Shoqërisë;
  - Kryerjen e çdo detyre tjetër të parashikuar nga ligji ose ky Statut.
- 10.6 Administratori mund të autorizojë nëpërmjet një prokure një palë të tretë të përfaqësojë Shoqërinë dhe të nënshkruajë çdo dokument, kërkesë ose aplikim në emër dhe për llogari të Shoqërisë.



- 10.7 Administratori detyrohet të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi.
- 10.8 Administratori është përgjegjës ndaj Shoqërisë për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e mos përbushjes së detyrimeve të parashikuara nga dispozitat e këtij Statuti dhe ligjit.

#### **Neni 11**

#### **Ekspert(et) Kontabël të jashtëm**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë do të auditohen të paktën një herë në vit nga një apo më shumë, ekspert kontabël të jashtëm. Me marrjen në dorëzim të raportit përkatës të auditimit administratori i Shoqërisë do të marrë të gjitha masat përkatëse për ndreqjen e parregullsive të konstatuara nëpërmjet raportit.

### **KAPITULLI IV**

#### **VITI FINANCIAR – SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

#### **Neni 12**

#### **Viti Financiar**

- 12.1 Viti financiar fillon më datë 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.
- 12.2 Përfundimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2022.

#### **Neni 13**

#### **Shpërndarja e fitimeve**

Pas miratimit të pasqyrave financiare dhe në rast se janë realizuar fitime ose humbje, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me shpërndarjen e fitimeve, krijimin e rezervave ligjore sikur edhe mbulimin e humbjeve. Pavarishtësht, ndarja e fitimeve realizohet sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme, kur kanë nënshkruar 100% e ortakëve të shoqërisë.

### **KAPITULLI V**

#### **PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

#### **Neni 14**

#### **Prishja dhe Likuidimi**

Në rast se Asambleja e Përgjithshme vendos për prishjen e Shoqërisë, ajo kalon në likuidim të thjeshtëzuar dhe do të emërojë një ose më shumë likuidues.

### **KAPITULLI VI**



## DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

### Neni 15

#### Ligji i zbatueshëm

Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare.

### Neni 16

#### Të ndryshme

Ky Statut është hartuar dhe nënshkruar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë secila.

## ORTAKËT

### Interinvest Albanian Group shpk

Hergys Rreli

Bujar Bendo

Nelsi Gega



The image shows three handwritten signatures in blue ink, each written over a horizontal line. The signatures are: Hergys Rreli (left), Bujar Bendo (middle), and Nelsi Gega (right). Below each signature is a long, sweeping horizontal stroke.